

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
19	Për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive të grave në jetën publike dhe politike, duke përfshirë zgjedhjet për kryebashkiakë, autoritetet në të gjitha nivelet duhet të ndërmarrin përpjekje gjithëpërfshirëse ligjore, institucionale dhe edukative për të kapërcyer stereotipet gjinore ekzistuese. Partitë politike duhet të identifikojnë dhe kufizojnë çdo pengesë të mundshme me bazë gjinore për kandidatet gra, duke përfshirë rishikimin e praktikave aktuale brenda partive që pengojnë përfaqësimin më efektiv të grave brenda strukturave partiake dhe si candidate.	Progres i Pamjaftueshëm	Zbatimi i kuotave gjinore vetëm për listat e candidateve, 1 në 3 kandidatë për zgjedhjet parlamentare dhe 1 në 2 kandidatë për këshillat bashkiak nuk mjafton për mbështetjen e grave për pjesëmarrje në jetën publike dhe politike. Aktualisht nuk ka asnjë propozim për mënyrën se si duhet të trajtohet ky problem në rastin e zgjedhjes së kryetarit të bashkisë. Organizata të shoqërisë civile kanë propozuar zgjidhje që rregullojnë, në mënyrë propocionale mbështetjen financiare dhe aksesin në media te grave /vajzave për zhvillimin e fushatës së tyre zgjedhore. Këto nuk janë pasqyruar në Kodin zgjedhor. Partitë politike nuk kanë miratuar ndryshime në statutin e tyre për të mirë rregulluar përfaqësimin e grave në strukturat e tyre partiake.